



AGJENCIA E REGJISTRIMIT CIVIL
AGENCIJA ZA CIVILNU REGISTRACIJU
CIVIL REGISTRATION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA E KOSOVËS
AGJENCIA E REGJISTRIMIT CIVIL-AGENCIJA ZA CIVILNU REGISTRACIJU
AGENCIJA ZA CIVILNU REGISTRACIJU
10.12.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS-KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA
Nr./Br. 018 2782/18
Data 10-12-2018
PRISHTINE-PRISHTINA


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS
KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA
KOSOVO CADASTRAL AGENCY

PROCEDURA STANDARDE E OPERIMIT

ARC DHE AKK

Përmbajtja

1. QËLLIMI DHE NEVOJAT OPERATIVE PËR UDHËZUES (PSO)	2
1.1 Nevojat operative për Procedurën Standarde të Operimit	2
1.2 Qëllimi për Procedurën Standarde të Operimit.....	2
2. BAZA LIGJORE	2
2.1 Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale	3
2.2 Udhëzimi Administrativ i ARC-së	3
2.3 Memorandum Bashkëpunimi (MOU)	3
3. SHKËMBIMI I TË DHËNAVE	3
3.1 Mënyra e shkëmbimit të të dhënave:	3
3.2 Ruajtja e gjurmëve (log-at) gjatë shkëmbimit të shënimeve:	5



1. QËLLIMI DHE NEVOJAT OPERATIVE PËR UDHËZUES (PSO)

1.1 Nevojat operative për Procedurën Standarde të Operimit

Duke pasur parasysh nevojën e institucioneve për të përmirësuar kualitetin e shënimeve dhe për të ofruar shërbime sa më të mira, më të shpejta dhe më të sakta, ka lindur nevoja e vendosjes së bashkëpunimit në mes të Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC) dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK).

Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) posedon sisteme të ndryshme, të cilat përmbajnë të dhëna të rëndësishme për qytetaret, duke filluar nga të dhënat personale e deri tek të dhënat e automjeteve.

Ofrimi i të dhënave të caktuara për Sistemin e AKK-së është me rëndësi pasi që i mundësohet kërkimi dhe identifikimi i saktë i të dhënave përkatëse përmes parametrave të caktuar.

1.2 Qëllimi për Procedurën Standarde të Operimit


Qëllimi i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është trajtimi i kërkesave për të dhënat nga ARC-ja drejt AKK-së, si në marrjen e shënimeve për një entitet ashtu edhe në verifikimin e të dhënave të entitetit.

Varësisht nga rasti që do të paraqitet për marrjen e shënimeve, do të caktohet mënyra e marrjes së shënimeve. Me këmbimin e këtyre shënimeve në mes të këtyre dy institucioneve do të arrihet një besueshmëri për të dhënat që do të trajtohen.

ARC dhe AKK do të sigurojnë zbatimin e dispozitave të fshehtësisë dhe mbrojtjes së të dhënave. AKK ka obligim që të dhënat të cilat ajo i merr në bazë të marrëveshjes së arritur do t'i shfrytëzoj vetëm për qëllimin përkatës dhe nuk do t'i shpërndaj tek pala e tretë.

2. BAZA LIGJORE

Të dy institucionet kanë mandat për të kërkuar të dhënat në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, memorandum bashkëpunimit (MOU) përkatës, për qëllime të ligjshme dhe kryerjen e detyrave të tyre. Qëllimi i shkëmbimit të informacionit është për të rritur efikasitetin e punëve operative.



2.1 Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale

Të dhënat që shkëmbehen duhet të jenë në përputhje me ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, ku definohet përpunimi i të dhënave, të dhënat e ndjeshme personale, si dhe procedimi i këtyre të dhënave personale për rastet kur është e nevojshme.

2.2 Udhëzimi Administrativ i ARC-së

Kjo Procedurë Standarde e Operimit është në përputhje edhe me Udhëzimin Administrativ të ARC-së për llojin dhe sasinë e informacionit që mund tu jepet institucioneve dhe organeve kërkuese.

2.3 Memorandum Bashkëpunimi (MOU)

Kjo Procedurë Standarde e Operimit bazohet në Memorandum Bashkëpunimin (MOU) ndërmjet Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK).

3. SHKËMBIMI I TË DHËNAVE

Ky dokument përshkruan strukturën e përgjithshme të automatizimit të procesit të marrjes së të dhënave të ARC-së për AKK.

Ideja është që përmes kësaj qasje të eliminohet marrja e kopjeve fizike me të dhënat, eliminimin e gabimeve në shënime, përpunimi - qasja e shënimeve në kohë reale, në shënime të sakta si dhe ofrimin e shërbimeve të lehtësuara si për zyrtarët e institucioneve ashtu edhe për qytetaret e Republikës së Kosovës.

3.1 Mënyra e shkëmbimit të të dhënave:

Shkëmbimi i të dhënave do të realizohet përmes platformës qeveritare Government Gateway (GG), e cila administrohet nga ana e ASHI-së, ku do të mundësohet transferimi i të dhënave në formë të enkriptuar që do të pamundësoj marrjen e të dhënave nga persona të paautorizuar gjatë transmetimit në rrjetë.

Shkëmbimi i të dhënave do të realizohet për Regjistrin e Pronave SIKTK me ID S10010. Të dhënat të cilat do të shkëmbehen janë:

1. Numri personal;

2. Emri
3. Mbiemri
4. MbiemriIPare
5. KomunaRegjistrimitID
6. KomunaLindjesID
7. KomunaLindjes
8. VendiLindjesID
9. VendiLindjes
10. Datelindja
11. GjiniaID
12. StatusiMartesor
13. StatusiJetesor
14. Shtetesia
15. NumriPersonalIBabai
16. EmriMbiemriBabait
17. NumriPersonalINenes
18. EmriMbiemriNenes
19. NumriPersonalBashkeshortit
20. KomunavendbanimitID
21. Komunavendbanimit
22. VendbanimiID
23. Vendbanimi
24. Adresa
25. KaShteetsi
26. MbiemriIVajzerisSeNenes
27. Gabimi

Thirrja e këtyre të dhënave do të bëhet me metodën ku si parametra hyrës janë:

1. Numri personal
2. Kodi i certifikatës (ID)
3. IP e shfrytëzuesit
4. Te dhënat e shfrytëzuesit(user name)

10/10/10
10/10/10
10/10/10

3.2 Ruajtja e gjurmëve (log-at) gjatë shkëmbimit të shënimeve:

Të dy institucionet janë të obliguara që gjatë shkëmbimit të informacioneve të bëjnë ruajtjen e gjurmëve (log-ve), për secilin kërkim që kryhet nga sistemet përkatëse. Tabela e gjurmëve duhet të mundësoj informatat së kush ka realizuar qasje, në cilën kohë dhe cilat informata janë kërkuar e të cilat duhet të jenë të auditueshme, çdo herë kur shihet si e nevojshme.

Institucioni: ARC

Zyrtari: Genc Hamzaj

Email: genc.hamzaj@rks-gov.net

Kontakti: 038 200 19 229

Nënshkrimi: 

Data: 10.12.2018

Institucioni: AKK

Zyrtari: Afërdita Thaçi

Email: aferdita.thaci@rks-gov.net

Kontakti: 038 200 30 274

Nënshkrimi: 

Data: 10.12.2018



